



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 40, paragrafi 40.2, pika b të Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28 qershor 2008), nenit 61, paragrafi 61.2 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nr. 03/L-048, nenit 33, paragrafi 33.1, pika b dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 01.10.2021, merr këtë

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË PRISHTIËS PËR VITIN 2022
DHE KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE PËR PERIUDHËN 2022-2024

- I. Miratohet buxheti i Komunës së Prishtinës për vitin 2022 dhe Korniza afatmesme buxhetore për periudhën 2022-2024.
- II. Shuma e propozuar e buxhetit për vitin 2022, të cekur në pikën 1 të këtij vendimi, është 90,669,333 €.
- III. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është tabela e planit të buxhetit për vitin 2022 dhe Korniza afatmesme buxhetore për periudhën 2022-2024.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-400/03-209726/21, më 04.10.2021

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

